

MARRËVESHJE PËR ZGJIDHJEN E KONTRATËS SË SHITJES SË KUOTAVE

Hyrje

Kjo marrëveshje për zgjidhjen e kontratës së shitjes së kuotave (në vijim **"Marrëveshja e Zgjidhjes"**) është lidhur në Tiranë, më datë 30.11. 2025, ndërmjet palëve të mëposhtme:

- Z. Olsi Çoku, lindur më 24.05.1985, mbajtës i ID nr. personal I50524061O, (në vijim **"Blerësi"**); dhe
- Z. Përparim Kalo, lindur më 12.12.1957, mbajtës i ID nr. personal F71212078J, (në vijim **"Shitësi"**).

Referuar më tej së bashku si **"Palët"**.

(Blerësi dhe Shitësi referuar së bashku si **"Palët"**.)

Palët deklarojnë sa vijon:

- Më datë 21 shkurt 2025, Palët kanë lidhur një kontratë shit-blerjeje kuotash (në vijim **"Marrëveshja e Shitjes"**) për transferimin e 7.5% të kapitalit të shoqërisë **"KALO & ASSOCIATES"** sh.p.k. nga Shitësi tek Blerësi.
- Deri në ditën e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje të Zgjidhjes, asnjë shumë nga çmimi i blerjes i parashikuar në Marrëveshjen e Shitjes nuk është paguar nga Blerësi.
- Palët dëshirojnë të zgjidhin Marrëveshjen e Shitjes në mënyrë të ndërsjellë, pa kundër shpërblim dhe pa pasoja juridike a financiare për secilin paie, duke rivendosur gjendjen e mëparshme sa i takon pronësisë së kuotës së shitjes dhe pa pretendime të mëtejshme të tashme apo të ardhme nga asnjëra palë ndaj palës tjetër.

Dispozitat Kryesore

Në bazë të sa më sipër, Palët bien dakord si vijon:

1. Palët bien dakord të zgjidhin me efekt të menjëhershëm Marrëveshjen e Shitjes të datës 21.02.2025, të lidhur ndërmjet tyre. Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje të Zgjidhjes, Marrëveshja e Shitjes konsiderohet e zgjidhur dhe nuk prodhon më asnjë efekt detyrues ndërmjet Palëve.
2. Palët konfirmojnë se asnjë pjesë e çmimit të blerjes nuk është paguar nga Blerësi deri në këtë datë. Për rrjedhojë, nuk ekziston asnjë detyrim pagese i papërmbytur midis Palëve sa i takon Marrëveshjes së Shitjes; Blerësi nuk ka detyrim të paguajë shumën e mësipërme, dhe Shitësi nuk ka detyrim të kthejë asnjë shumë ndaj Blerësit.
3. Blerësi heq dorë nga çdo e drejtë, titull apo interes mbi kuotën e shitjes prej **7.5%** të kapitalit të **"KALO & ASSOCIATES"** sh.p.k., e cila ishte objekti i Marrëveshjes së Shitjes, dhe e transferon atë menjëherë e pa kushte tek Shitësi. Si rezultat, Shitësi rimerr pronësinë e plotë të kësaj kuote në kapitalin e shoqërisë, pa asnjë kufizim apo pretendim nga ana e Blerësit. Palët do të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për formalizimin e menjëhershëm të këtij transferimi në organet kompetente të regjistrimit.




4. Palët bien dakord që asnjëra palë nuk do t'i kërkojë palës tjetër asnjë kompensim, dëmshpërblim. Secila Palë heq dorë nga çdo padi, pretendim, e drejtë apo detyrim i mundshëm ndaj palës tjetër, pas nënshkrimit të Marrëveshje të Zgjidhjes.
5. Kjo Marrëveshje e Zgjidhjes rregullohet nga ligjet në fuqi të Republikës së Shqipërisë. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet Palëve në lidhje me këtë marrëveshje do të zgjidhet në mënyrë miqësore midis Palëve; nëse një zgjidhje miqësore nuk arrihet, juridiksioni i takon gjykatave kompetente shqiptare, konkretisht Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
6. Kjo marrëveshje përbën të gjithë marrëveshjen midis Palëve lidhur me objektin e saj (zgjidhjen e Marrëveshjes së Shitjes). Ajo hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga të dyja Palët. Menjëherë pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje të Zgjidhjes, **Shitësi do të zotërojë në kapitalin e shoqërisë KALO & ASSOCIATES një kuotë, e cila përfaqëson 37.5% të kapitalit të saj.**
7. Kjo marrëveshje është hartuar në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe; secila Palë merr nga një kopje të nënshkruar, ndërsa kopja e tretë do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), në përputhje me ligjin shqiptar për regjistrimin e ndryshimeve në shoqëritë tregtare.

Nënshkrimet

Shitësi: Përparim Kalo

Blerësi: Olsi Çoku

The image shows two handwritten signatures in blue ink. The first signature, for Përparim Kalo, is written over a horizontal line. The second signature, for Olsi Çoku, is also written over a horizontal line. Both signatures are cursive and stylized.